

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shaip Muja i dërgon letër Hagës: Besoj në pafajësinë e ish-drejtimesve, vendimi të bazohet vetëm mbi prova
ADRESA	https://albeu.com/kosove/shaip-muja-i-dergon-leter-hages-besoj-ne-pafajesine-e-ish-drejtuesve-vendimi-te-bazohet-vetem-mbi-prova/1007670/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 18:34:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 18:34:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	df240ba860e147a6f28720ceecab34d09568e228701b8051536d4d753f3e2a47
TEKSTI	92511fb78ef8ece05b4e79af86f5c4dd9547f2e9991bf81839116baaec5f535c
PAMJA	bf934a272225bf882050fc5a01ca5daad23ac5752ec317e7a0d8b3dfe53220df

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f83dc8eb7dc1ac6a53fade0687a80ed945892a0ab40efb1d5c4fafce626d46bd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	648cf5643b7eec9631eeb9308ec676d258ca5b066518a7d2fcbfc98479d63336
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f83dc8eb7dc1ac6a53fade0687a80ed945892a0ab40efb1d5c4fafce626d46bd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

[Skip to content](#)

[Albeu.com](#)

- [lajme](#)
- [kosovë](#)
- [maqedoni](#)
- [sport](#)
- [showbiz](#)
- [lifestyle](#)
- [tech](#)
- [moti](#)
- [LiveTV](#)

search

- [lajme](#)
- [kosove](#)
- [maqedoni](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [lifestyle](#)
- [shendetesi](#)
- [receta gatimi](#)
- [enciklopedi](#)
- [english](#)
- [sport](#)
- [tech](#)
- [auto](#)
- [livescore](#)
- [REZULTATET ZGJEDHJET 2025](#)
- [moti në shqipëri](#)
- [moti në kosovë](#)
- [moti në maqedoni](#)
- [travel](#)

Shaip Muja i dërgon letër Hagës: Besoj në pafajësinë e ish-drejtuesve, vendimi të bazohet vetëm mbi prova

Ish-deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, dr. Shaip Muja, ka dërguar një letër drejtuar Dhomave të Specializuara në Hagë, ku shprehet se pasi u mor në pyetje në vitin 2019, zgjodhi të heshtë publikisht për shkak se ishte thirrur në cilësinë e të dyshuarit, lidhur me akuzat e ngritura në Raportin e Dick Marty-t.

Muja rikujton se në atë kohë u paraqit pa avokat mbrojtës, ndonëse kjo mundësi i ishte ofruar, dhe u kishte thënë hetuesve: "Nëse keni fakte, më arrestoni, sepse nuk kam për çfarë të kem frikë". Ai rikonfirmon bindjen e tij se pretendimet për trafikim të organeve njerëzore, të ngritura ndaj tij dhe pjesëtarëve të tjerë të UÇK-së, kanë qenë të pavërteta.

Në letrën e tij, ish-deputeti shpreh kritika të ashpra për mënyrën se si, gjatë viteve, pretendimet e raportit të Dick Marty-t janë shndërruar në akuza të rënda publike. Ai shton se këto akuza i kanë sjellë pasoja të prekshme atij personalisht dhe familjes së tij.

Muja deklaron hapur se qëndron pas Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit, duke besuar fuqishëm në pafajësinë e tyre. Një shqetësim i veçantë në letrën e tij është edhe kohëzgjatja e procesit gjyqësor dhe periudha e gjatë që të akuzuarit po kalojnë në paraburgim, teksa thekson se vendimi përfundimtar duhet të mbështetet vetëm në prova dhe në ligj.

Sipas tij, rasti i katër të akuzuara ka një peshë që tejkalon fatin e tyre personal, pasi vendimi mund të formësojë mënyrën se si do të kujtohet dhe interpretohet lufta e Kosovës. Ai insiston se gjykimin duhet të bëhet i shkëputur nga bindjet politike dhe perceptimet e ngulitura përgjatë viteve.

"Faktet, ligji dhe drejtësia duhet të jenë më të forta se stigmatizimi, propaganda, politika dhe paragjykimin", përmbyll letrën dr. Shaip Muja. Në shkresë, ai sqaron se heshtja e tij për vite me radhë nuk ishte pranim i akuzave, por respekt për një proces gjyqësor në zhvillim.

Ai e cilëson Raportin e Dick Marty-t një dokument politik të miratuar në Këshillin e Europës, i cili, sipas tij, gjeneroi pasoja të mëdha institucionale dhe juridike, duke i ekspozuar disa njerëz ndaj dyshimit publik shumë përpara se drejtësia të jepte fjalën e saj. Muja tërheq vëmendjen edhe mbi kontekstin politik, duke përmendur interesin e Serbisë për të ndikuar në interpretimin e luftës dhe rolit të UÇK-së, duke përdorur gjithashtu materiale dhe pretendime nga burime serbe.

Ai pranon se prejardhja e një informacioni nuk e zhvlerëson automatikisht atë si provë, por insiston se konteksti në të cilin u sajuan dhe u përhapën disa akuza nuk mund të injorohet. Muja rrëfen se është përballur me përgojime të vazhdueshme, duke e trajtuar dyshimin ndaj tij si fakt të vërtetuar, gjë që e ka dëmtuar në sferën profesionale, publike dhe personale.

Ndonëse nuk ia mohan askujt të drejtën për të menduar ndryshe, ai ngre pyetjen se ç'mbetet nga prezumimi i pafajësisë kur dikush jeton gati 16 vjet nën peshën e një akuze publike të paprovuar. Muja ripohon krenarinë për luftën e UÇK-së dhe e cilëson atë një ushtri çlirimtare, por shton se askush nuk është mbi ligjin.

Ai paralajmëron se një dënim i mundshëm i drejtuesve kryesorë të UÇK-së do të përdorej dhe do të interpretohej si një gjykim mbi vetë organizatën dhe karakterin e luftës së saj, duke sjellë pasoja historike dhe politike përtej atyre juridike individuale. Megjithatë, ai thekson se përgjegjësia individuale, nëse provohet, nuk mund të shndërrohet në përgjegjësi të një organizate të tërë apo në një gjykim mbi luftën e Kosovës.

Muja nënvizon se Kosova nuk u çlirua e vetme dhe se roli i NATO-s, SHBA-së dhe vendeve europiane ishte vendimtar, duke shtuar se orientimi euroatlantik mbetet një zgjedhje strategjike e shtetit të Kosovës. Ai kujton gjithashtu se vetë Dhomat e Specializuara u krijuan përmes institucioneve të Kosovës dhe se të akuzuarit nuk iu shmangën drejtësisë kur u thirrën.

Në letër, ai shpreh shqetësimin për një proces gjyqësor kaq të zgjatur dhe për vitet e kaluara në paraburgim nga persona që ende gëzojnë prezumimin e pafajësisë. Ai shton se një gjykatë nuk duhet të ndikohet nga pyetjet nëse të akuzuarit do të kenë apo jo rol politik në të ardhmen.

Muja sqaron se mbështetja e tij për të akuzuarit nuk është një kërkesë që gjykata të ndajë bindjen e tij, por shpreson që pas përfundimit të procesit, ata të kthehen të lirë në Kosovë. Ai insiston se vendimi përfundimtar nuk duhet të formësohet as nga bindjet e tij, as nga ato të atyre që i kanë shpallur fajtorë që më parë, por vetëm nga ajo që është provuar në sallën e gjyqit.

Ai e mbyll letrën duke thënë se për të kjo histori nuk është thjesht një debat abstrakt, por një pjesë e jetës me kosto reale, dhe se e vetmja gjë që kërkon është që vlerësimi juridik të mos ndikohet nga gjithçka që është thënë dhe shkruar në këto vite.

Lajme të ngjashme:

Shtuar më 11.09.2026 20:34

Tags: [pdk](#), [Shaip Muja](#)

[Apeli ndryshon vendimin dhe shpall të pafajshëm Agim Çekun dhe nëntë të akuzuar të tjerë në rastin e veteranëve](#)

[Apeli ndryshon vendimin dhe shpall të pafajshëm Agim Çekun dhe nëntë të akuzuar të tjerë në rastin e veteranëve](#)

[Dogana e Kosovës paraqet kriteret për përfaqësuesit doganorë](#)

[Dogana e Kosovës paraqet kriteret për përfaqësuesit doganorë](#)

[Burjani: Kushtëzimi i votës për Presidentin po bllokon formimin e Kuvendit](#)

[Burjani: Kushtëzimi i votës për Presidentin po bllokon formimin e Kuvendit](#)

[Milazim Maraj: Deklarata e Igor Simiqit synon sabotimin e institucioneve të Kosovës](#)

[Milazim Maraj: Deklarata e Igor Simiqit synon sabotimin e institucioneve të Kosovës](#)

[Bajqinovci: LVV nuk i mbështeti kandidatët e LDK-së dhe PDK-së për nënkryetarë, pasi synon shmangien e zgjedhjeve](#)

[Bajqinovci: LVV nuk i mbështeti kandidatët e LDK-së dhe PDK-së për nënkryetarë, pasi synon shmangien e zgjedhjeve](#)

[Ardian Gjini zhvillon takim me Anu Prattipatin](#)

[Ardian Gjini zhvillon takim me Anu Prattipatin](#)

[Isufaj zhvillon takim me të ngarkuarën me punë të Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë](#)

[Isufaj zhvillon takim me të ngarkuarën me punë të Ambasadës së SHBA-së në Prishtinë](#)

[Zulfaj takohet me ambasadoren e Finlandës, në fokus rruga e Kosovës drejt BE-së](#)

[Zulfaj takohet me ambasadoren e Finlandës, në fokus rruga e Kosovës drejt BE-së](#)

Posted in [kosovë](#) Tagged [pdk](#), [Shaip Muja](#)

të fundit

[Mickoski: Mbi 500 familje sociale përfituan vauçerë për klima inverter](#)

[Mickoski: Mbi 500 familje sociale përfituan vauçerë për klima inverter](#)

[Don Xhoni i bashkohet thirrjes për krerët e UÇK-së: Nuk po gjykohen veç ata, por edhe një pjesë e historisë tonë](#)

[Don Xhoni i bashkohet thirrjes për krerët e UÇK-së: Nuk po gjykohen veç ata, por edhe një pjesë e historisë tonë](#)

[LIVE/ Qytetarët vijojnë protestën prej 104 ditësh, kërkojnë largimin e Ramës](#)

[LIVE/ Qytetarët vijojnë protestën prej 104 ditësh, kërkojnë largimin e Ramës](#)

[Rama: Do të vijë koha të shpjegoj deklaratën për dorëheqjen](#)

[Rama: Do të vijë koha të shpjegoj deklaratën për dorëheqjen](#)

[Zbulohet formacioni ideal i javës në Ligën e Kampionëve](#)

[Zbulohet formacioni ideal i javës në Ligën e Kampionëve](#)

[Detaje tronditëse për vdekjen e papritur të Mazonakis/ Pasi situata u doli nga kontrolli, mjekët përdorën ChatGPT për mënyrën e rikthimit në jetë dhe e...](#)

[Detaje tronditëse për vdekjen e papritur të Mazonakis/ Pasi situata u doli nga kontrolli, mjekët përdorën ChatGPT për mënyrën e rikthimit në jetë dhe e...](#)

[Autokolona me makina dhe flamuj shqiptarë ndalohet në Mal të Zi, emigrantit: Do të vijmë në protestë edhe përmes maleve](#)

[Autokolona me makina dhe flamuj shqiptarë ndalohet në Mal të Zi, emigrantit: Do të vijmë në protestë edhe përmes maleve](#)



[Esim for Global](#) | [Esim for Europe](#) | [Esim for Caribbean](#) | [Esim for USA](#) | [Esim for Italy](#) | [Esim for Spain](#) | [Esim for Turkey](#) | [Esim for Germany](#) | [Esim for Greece](#) | [Esim for Asia](#) | [Esim for World Cup 2026](#) | [Esim for Saudi Arabia](#) | [Esim for Egypt](#) | [Esim for United Arab Emirates](#) | [Esim for Balkans](#) | [Esim for Morocco](#) | [Esim for China](#) | [Esim for United Kingdom](#) | [Esim for Africa](#) | [Esim for Latin America](#) | [Esim for GCC Gulf Cooperation Council](#) | [Esim for Middle East](#) | [Esim for South America](#) | [Esim for Canada](#) | [Esim for Mexico](#) | [Esim for Japan](#) | [Esim for Albania](#) | [Esim for Kosovo](#) | [Esim for Switzerland](#) | [Esim for Tunisia](#) | [Esim for South Africa](#) | [Esim for Algeria](#) | [Esim for Portugal](#) | [Esim for Brazil](#) | [Esim for Argentina](#) | [Esim for Colombia](#) | [Esim for Hong Kong](#) | [Esim for Thailand](#) | [Esim for Macau](#) | [Esim for Malaysia](#) | [Esim for Vietnam](#) | [Esim for South Korea](#) | [Esim for Austria](#) | [Esim for Netherlands](#) | [Esim for Australia](#) | [Esim for Russia](#) | [Esim for India](#) | [Esim for Chile](#) | [Esim for Peru](#) | [Esim for Poland](#) | [Esim for North Macedonia](#) | [Esim for Sweden](#) | [Esim for Finland](#) | [Esim for Norway](#) | [Esim for Belgium](#)
[Albeu.com](#)

© 2003 - 2026 Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kryesore

- [Erion Vellaj](#)
- [Free Esim](#)
- [Zgjedhjet 2025](#)
- [Belinda Balluku](#)
- [SPAK](#)
- [Kombëtarja](#)

Kategori

- [Lifestyle](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Argetim](#)
- [Enciklopedi](#)

Linqet

- [Live tv shqiptare](#)
- [Moti në Shqipëri](#)
- [Travel](#)
- [Horoskopi](#)
- [Livescore](#)
- [News from Albania](#)

Tags

- [Edi Rama](#)
- [Albania News](#)
- [Ilir Meta](#)
- [Piranjat](#)
- [gazeta, tv, portale](#)
- [Sali Berisha](#)

Moti

- [Moti në Tiranë](#)
- [Moti në Prishtinë](#)
- [Moti në Shkup](#)
- [Moti në Durrës](#)
- [Moti në Prizren](#)
- [Moti në Tetovë](#)

© 2003 - 2026 Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

- [Kontakttoni](#)
- [Kushtet e Përdorimit](#)
- [Privacy Policy](#)
- [Powered by: orihost.com](#)